



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.10/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 21/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese , me seli në fshatin Komuna e , me përfaqësues , dhe Përmbarduesi Privat, me datën 20.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-10/2022 i datës 01.04.2022, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, me seli në fshat , Komuna e me përfaqësues datës 29.03.2022, **si te pa bazuara.**

II. Përmbarduesi Privat , si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr. 21/2022.

A r s y e t i m

Me datën 29.03.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Private, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën degjimore, me të cilën pretendon se përmbarduesi privat, thekson se ju është bërë shënimi i përmbardimit në zyrën komunale kadastrale në komunën e Graçanicës, lidhur me paluajtshmërinë që ka qenë objekt përmbardimi, e për të cilën pala ankuese është njoftuar nga zyra kadastrale me datën 15.03.2022, ku palës ankuese i është pa mundur pajisja me kopje të planit lidhur me këtë paluajtshmëri. Shënimi i përmbardimit është bërë për kundër faktit që pala debitore ka parashtruar prapësim ndaj urdhrorit të përmbarduesit privat. Me propozim për komisionin që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbarduesi privat.

Me datën 01.04.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për Përfundimtar ndaj përmbarruesit privat, lidhur me veprimet përmbarrimore për këtë lëndë.

Përmbarruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se shënimi i përmbarrimit është bërë bazuar në dispozitat e procedurës përmbarrimore pasi që organi përmbarrues e lejuar përmbarrimin, dhe konform nenin 204 të LPP-së, ka nxjerr konkluzion për shënim të përmbarrimit në librat publik të paluajtshmërisë, bazuar në kontratën e hipotekës LRP-1376/2020, me kërkesë të kreditorit ky shënim i përmbarrimit është tërhequr dhe lënda gjendet sipas prapësimit në gjykatë. Me propozim për komision që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbarruesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbarruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi pretendimin e palës ankuese se ju është shkaktuar dëm sa i përket shënimit të përmbarrimit nga përmbarruesi dhe pa mundësia e pajisjes me kopjen e planit të paluajtshmërisë pasi në atë kohë pala ankuese është dëmtuar sa i përket pjesëmarrjes në tender.

Për sa i përket shënimit të përmbarrimit nga përmbarruesi dhe pa mundësia e pajisjes me kopjen e planit të paluajtshmërisë lëndor siç pala ankuese. Më këtë rast komisioni vlerësoi se shënimi i përmbarrimit nuk është pengesë për pajisje me kopje të planit për paluajtshmërinë lëndore dhe përmbarruesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim përmbarrimor por lëndën e ka dërguar në gjykatë për vendosje sipas prapësimit. Për këto arsye komisioni vlerëson se përmbarruesi privat nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet e masave disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbarrimore për rastin të cilën është paraqitur ankesa janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARRUESIT PRIVAT

DPL.nr 10/2022 datë 20.05.2022

Kryesuese e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.